



**MINISTRIA E DREJTËSISË**

**DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS**

**ANALIZË STATISTIKORE  
NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI**

*Të dhëna statistikore mbi ndihmën juridike parësore dhe dytësore*

**JANAR 2022**

**DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS**

**Botim i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas**

*© Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenues me çfarëdo lloj mjete apo formë*

**H Y R J E**.....

**KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore**.....

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.....

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara.....

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.....

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjelhër 08001010 .....

Numri i Gjelhër 08001010 .....

Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore.....

Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas natyrës së çështjes) .....

Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas kategorisë përfituese).....

**KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE**.....

Të dhëna statistikore: Kategoria Femra / Meshkuj.....

Të dhëna statistikore: Kategoria përfituese me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.....

Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të ofruar.....

Të dhëna statistikore: Vendimi i Gjykatës / Organit procedues.....

Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.....

Të dhëna statistikore: Gjykata që ka dhënë vendimin.....

**KONKLUSIONE**.....

## HYRJE

**Qëllimi i këtij punimi** është krijimi i një analize statistikore të unifikuar sa i përket sistemit të ndihmës juridike ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr. 111/2017, **“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”** dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e cila ndikon drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e politikave të mëtejshme në fushën e ndihmës juridike falas nga Ministri i Drejtësisë.

Referuar shkronjës “d”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike, mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitim të saj.

Gjithashtu, referuar shkronjës “gj”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, **Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.**

Procedura e mbajtjes, mbledhjes, plotësimit si dhe administrimit të këtyre të dhënave është e përcaktuar shprehimisht në udhëzimin nr. 1, datë 08.03.2019, **“Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”**.

**Referuar këtij udhëzimi**, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është organi përgjegjës për mbajtjen, mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e:

a) Të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mblidhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetëdeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.

Në regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore dhe dytësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- Kërkuesi (Emri, Mbiemri);
- Gjinia,
- Datëlindja,
- Shtetësia,
- Gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- Gjendja e punësimit,
- Adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- Gjykata/Organi procedues pranë të cilit është dorëzuar kërkesa;
- Lloji i vetëdeklarimit;
- Lloji i ndihmës dytësore të kërkuar;

- Çështje juridike;
- Vendimi i gjykatës/organit procedues mbi kërkesën për ndihmë juridike;
- Data/Nr. i vendimit;
- Ankimim i vendimit;
- Pala ankimuese;
- Vendimi mbi ankimin;
- Avokati i caktuar;
- Pagesat e përfituara nga avokati;
- Rimbursimi i pagesave.

Udhëzimi parashikon se regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese mbahet në formë elektronike dhe bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vlerësohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

*Punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas*

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas autorizon me shkrim punonjës për plotësimin dhe përditësimin e regjistrave. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

Gjithashtu, udhëzimi parashikon se punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e regjistrave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistër, punonjësi i autorizuar bën korrigjimin dhe shkruan informacionin e saktë. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat

## KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore

### Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Referuar nenit 13 të ligjit 111/2017, Ndhimja juridike parësore jepet nga: *Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (përmes punonjësve me trajnim të posaçëm); Organizatat jofitimprurëse të autorizuara dhe Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.*


Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë patur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku shërbimi i ndihmës juridike falas (ofruar në mënyrë autonome nga ana e organizatave të ndryshme joqeveritare) ishte i mangët ose inekzistent por nga ana tjetër, edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin të mëdha.

Aktualisht, gjatë periudhës Janar 2022, Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas administron 10 (dhjetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti si vijon:

- ❖ **Tiranë** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Durrës** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Lezhë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Pogradec** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Lushnje** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Shkodër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Gjirokastrë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Fier** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Dibër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Vlorë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	Totali i Rasteve të raportuara	Mosha		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Çështjes			Përkatësia Etnike	Viktima Dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Specifikime															
<b>Tiranë</b>	<b>59</b>	-	59	14	45	59	-	10	7 (1 viktimë dhune)	42	28	10	21	-	1
<b>Lezhë</b>	<b>31</b>	-	31	21	10	31	-	27	4 (2 viktima dhune, 2 skema e mbrojtjes sociale)	-	24	1	6	2 romë	2
<b>Durrës</b>	<b>43</b>	-	43	19	24	43	-	36	7 (2 viktima dhune, 4 invalidë, 1 i verbër)	-	11	2	30	-	2
<b>Lushnje</b>	<b>16</b>	-	16	9	7	16	-	13	3 (2 ndihmë ekonomike, 1 KMCAP)	-	13	-	3	3 romë	
<b>Shkodër</b>	<b>21</b>	-	21	7	14	21	-	12	9 (6 KMCAP, 1 viktimë dhune, 2 ndihmë ekonomike)	-	16	4	1	1 rom	1
<b>Gjirokastrë</b>	<b>40</b>	-	40	20	20	40	-	24	16 (14 skema e mbrojtjes sociale, 2 aftësi e kufizuar)	-	16	-	24	2 romë	-
<b>Pogradec</b>	<b>16</b>	-	16	12	4	16	-	12	4 (2 të verbër, 2 ndihmë ekonomike)	-	12	3	1	-	-
<b>Fier</b>	<b>35</b>	-	35	19	16	35	-	25	9 (4 aftësi e kufizuar, 2 viktima dhune, 1 diskriminim, 1 i paaftë mendërisht, 1 skema sociale)	1	10	1	24	2 romë	2
<b>Dibër</b>	<b>8</b>	-	8	2	6	8	-	8	-	-	7	-	1	-	-
<b>Vlorë</b>	<b>27</b>	-	27	12	15	27	-	20	7 (2 të verbër, 2 invalidë, 3 skema e mbrojtjes sociale)	-	10	1	16	2 romë 2 egjiptianë	-
<b>TOTALI</b>	<b>296</b>		<b>296</b>	<b>135</b>	<b>161</b>	<b>296</b>		<b>187</b>	<b>66</b>	<b>43</b>	<b>147</b>	<b>22</b>	<b>127</b>	<b>14</b>	<b>8</b>


**Për muajin Janar 2022 janë administruar 296 raste nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore**






# Rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të


## Rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës



## Numri i subjekteve përfituese sipas kategorive



## Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë




## Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara

OJF e Autorizuar	Totali i Rasteve	Moshë		Gjinia		Shtetësia			Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyrë e çështjes		
		Mitur	Rritur	F	M	Shqiptar	I huaj	Pa shtetësi	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Admin
“Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza”	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--
“Mbrojtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	5	0	5	2	3	5	0	0	0	0	5	3	0	2
“Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara”	7	0	7	4	3	7	0	0	0	2 (persona me aftësi të kufizuar)	5	2	0	6
“Intelektualët e rinj shpresë”	7	0	7	2	5	7	0	0	5	2 (persona përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale)	0	3	0	4
CRCA	17	8	9	11	6	16	1	0	0	17 (1 i mitur në konflikt me ligjin, 8 viktima të abuzimit seksual; 8 viktima të dhunës në familje)	0	2	7	7
“Forumi i Gruas Elbasan”	6	0	6	5	1	6	0	0	3	3 (viktima të dhunës në familje)	0	6	0	0
“Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	30	26	4	17	13	12	2	16	30	0	0	0	0	30
“Të ndryshëm dhe të barabartë”	14	1	13	13	1	13	1	0	0	14 (10 viktima të dhunës në familje; 4 viktima të trafikimit)	0	7	1	6
“Albanian Legal and Territorial Institute “	30	0	30	18	12	30	0	0	5	2 (persona përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale)	23	30	0	0
“Qendra për nisma ligjore qytetare”	74	0	74	69	5	74	0	0	35	39 (36 viktima të dhunës në familje, 2 persona përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale; 1 person me aftësi të kufizuar)	0	54	2	18
“Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”	26	1	25	10	16	0	0	26	0	0	26	0	0	26
“Qendra Konsumatori Shqiptar” <sup>1</sup>	8	0	8	4	4	8	0	0	0	0	8	5	0	3
<b>TOTAL<sup>2</sup></b>	<b>224</b>	<b>36</b>	<b>188</b>	<b>155</b>	<b>69</b>	<b>178</b>	<b>4</b>	<b>42</b>	<b>78</b>	<b>79</b>	<b>67</b>	<b>112</b>	<b>10</b>	<b>102</b>


**Për muajin Janar 2022 janë administruar 224 raste nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara**

<sup>2</sup> 5 Romë dhe 3 Egjiptianë persona përfitues nga ndihma juridike parësore e ofruar nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara


## Numri i rasteve të raportuara nga OJF e autorizuara




### Numri i rasteve të raportuara sipas natyrës së çështjes



### Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë



### Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive të përcaktuara në ligj



■ Me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme ■ Kategori të Veçanta ■ Të paidentifikuar

## Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

Një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe **Klinikat e Ligjit**. Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore

Aktualisht Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje me 11 Institucione të Arsimit të Lartë, në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë, konkretisht:

1. **Fakulteti i Drejtësisë;**
2. **Kolegji Universitar “Wisdom”;**
3. **Klinika e Ligjit Shkodër (Hapur nga OSFA);**
4. **Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës;**
5. **Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;**
6. **“Universiteti European i Tiranës”;**
7. **“Universiteti “Qirjazi”**
8. **Universiteti “Bedër”**
9. **Universiteti “Mesdhetar”**
10. **Universiteti “Marin Barleti”**
11. **Universiteti “Luarasi”**
12. **Universiteti “Epoka”.**

*Referuar nenit 7 të marrëveshjeve Tip të bashkëpunimit: Klinikat Ligjore do të dëgojnë të dhëna periodike çdo muaj pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar/përfitur ndihmë juridike parësore. Të dhënat do të dërgohen brenda 5(pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.*

Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuar. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

**Për muajin Janar janë administruar 0 raste nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve**

Klinikat e ligjit	Totali i Rasteve të trajtuara	Moshë		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Cështjes			Përkatësia Etnike	Viktima dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategoritë e Vecantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Kolegji Universitar Ësdom	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kolegji universitar Bedër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kolegji Universitar Qiriazi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Mesdhetar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Europjan i Tiranës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Fakulteti i Drejtësisë, UT	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Ismail Qemali Vlorë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Klinika e ligjit në Shkodër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti “Marin Barleti”	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti “Epoka”	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-




## Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjelbër 08001010

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundësuar për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qenë të shumëllojëshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ sidomos në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e perhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi (Covid-19). Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksesshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre edhe pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. ***Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtrojnë problematikën e tyre në këtë platformë thjesht përmes adresimit të një pyetjeje, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitimin e ndihmës juridike parësore, të dhënat statisikore që mund të pasqyrojmë përkojnë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative)***

Rastet e trajtuara Janar 2022 (123 pyetje/pergjigje)		
LLOJI I ÇËSHTJES	NUMRI I PYETJEVE	NUMRI I PËRGJIGJEVE
Civile (pronësia, trashëgimia, detyrime, kontrata; tituj ekzekutiv, përfaqësim, tregtare)	40	40
Marrëdhënie pune (paga; zgjidhja e kontratës; pushimet e paguara)	2	2
Familjare (kujdestaria, pension ushqimor, zgjidhje martesë, njohje atësie)	9	9
Procedurë gjyqësore (afatet procedurale; të provuarit; ankimet)	10	10
Penale (aksesi në prokurori; vepra penale; afatet dhe procedurat hetimore; rehabilitimi)	8	8
Administrative (sigurime shoqërore, gjendja civile, taksa, gjoba; leje qëndrimi; shtetësia; akses në shërbime publike, NE)	43	43
Të tjera (ndihmë juridike falas, lëvizje jashtë shtetit; të dhënat personale; legjislacion)	11	11
<b>TOTAL</b>	<b>123 pyetje</b>	<b>123 përgjigje</b>



### Numri i Gjelbër 08001010


Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, Ministria ka vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosija e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard të lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit.

*Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton se qytetarët kanë shfaqur mjaft interes në përfitim të këtij shërbimi ligjor gjë që përbën një hap mjaft pozitiv në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi për qytetarët. Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtronjë problematikën e tyre thjesht përmes një telefonate, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitim të ndihmës juridike parësore, të dhënat statistikore që mund të pasqyrojmë përkojnë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative).*


**NUMRI I RASTEVE TË TRAJTUARA (Numri i gjelber 08001010)**

**TOTALI I RASTEVE (Telefonatave) 27**


Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore




**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas gjinisë)**



**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore  
(sipas natyrës së çështjes)**




**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore  
(sipas kategorisë përfituese)**



**Totali i rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore për muajin Janar 2022**

**670 raste**



## KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

### 1. Të dhëna statistikore: Sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Janar 2022, rezulton se për **61 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike falas, **34** prej tyre rezultojnë për kërkuese gra (**56%**) dhe **27** prej tyre për kërkues burra (**44%**). Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi kërkuesit sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra JANAR 2022		
<i>Kategoria Gra / Burra</i>	<i>Numri i kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Kërkues Gra	34	<i>Në vijimësi të trendit të zakonshëm, kërkuesit e ndihmës juridike falas për muajin Janar 2022 janë më shumë gra se kërkuesit burra.</i>
Kërkues Burra	27	
<b><u>TOTALI = 61 Vendime Gjyqësore</u></b>		

### 2. Të dhëna statistikore: Sipas kategorive përfituese, me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Janar 2022, rezulton se nga **61 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, **45** prej tyre rezultojnë për kërkues që pretendojnë se i përkasin kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme (**73%**) dhe **14** prej tyre rezultojnë nga kërkues që bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta sipas ligjit (**22%**).

Ndërsa për **2** përfitues nuk mund të evidentohet statusi i përfituesit i pretenduar, për shkak të moevidentimit të këtij fakti në përmbajtjen e vendimit gjyqësor të pushimit apo kthimit të akteve. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:



Të dhëna statistikore mbi kërkuesit sipas kategorive përfituese JANAR 2022			
<i>Kategoria përfituese</i>		<i>Numri i kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme		45	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm, kërkuesit e ndihmës juridike falas për muajin Janar 2022 janë më shumë qytetarë që pretendojnë të jenë në kushtet e pamundësisë financiare. 2. Ndërmjet kategorive të veçanta, numrin më lartë e kanë personat invalidë ose me aftësi ndryshe.
E pa specifikuar në vendimin gjyqësor		2	
Kategori e veçantë  (Total 14)	<i>Viktimë dhune / diskriminimi</i>	0	
	<i>Person me aftësi ndryshe / statusi i të verbërit</i>	13	
	<i>Përfitues nga skema e mbrojtjes sociale</i>	1	
	<i>Komuniteti Rom</i>	0	
	<i>Fëmijë dhe të mitur</i>	0	
<b><u>TOTALI = 61 Vendime Gjyqësore</u></b>			

### 3. Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të kërkuar nga qytetarët.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Janar 2022, rezulton se nga **61 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, **24** prej tyre janë kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore me avokat, **33** prej tyre janë kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore me avokate dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe **4** prej tyre janë kërkesa për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi llojin e ndihmës dytësore të kërkuar JANAR 2022		
<i>Lloji i ndihmës dytësore të ofruar</i>	<i>Numri i Përfituesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Ndihmë juridike dytësore me avokat	24	Në analizë të së tërës, shihet që në pjesën më të madhe, kërkuesit kërkojnë ndihmën juridike të përfaqësimit me avokat.
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	33	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	4	
<b><u>TOTALI = 61 Vendime Gjyqësore</u></b>		

#### 4. Të dhëna statistikore: Sipas vendimmarrjes së Gjykatave / Organit procedues për kërkesat.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Janar 2022, nga **61 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, rezulton se janë pranuar **55** kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore (**91%**) dhe janë rrëzuar **6** kërkesa për përfitim nga ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore (**9%**).

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

<b>Të dhëna statistikore vendimmarrjes së gjykatave ose organit procedues JANAR 2022</b>			
<i>Lloji i ndihmës dytësore të ofruar</i>	<i>Vendimi i Gjykatës / Organit Procedues Pranim / rrëzim pranim pjesërisht</i>	<i>Numri i Kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Ndihmë juridike dytësore përfaqësim me avokat	Pranuar	21	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm evidentohet një numër i ulët i vendimeve që rrëzojnë kërkesën e ndihmës juridike. 2. Në analizë të së tërësi, nuk evidentohet raport i caktuar ndërmjet refuzimeve përsa i përket llojit të ndihmës juridike.
	Rrëzuar	3	
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Pranuar	29	
	Rrëzuar	4	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Pranuar	4	
	Rrëzuar	0	
<b><u>TOTALI = 61 Vendime Gjyqësore</u></b>			

#### 5. Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Janar 2022, rezulton se nga **61 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën për ndihmën juridike, **46** prej tyre janë çështje civile (**75%**), **5** janë çështje administrative, dhe **10** janë çështje penale.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

**Të dhëna statistikore sipas natyrës së çështjes gjyqësore që kërkohet ndihma  
JANAR 2022**

<i>Lloji i çështjes</i>	<i>Numri i kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Çështje civile ( <i>pronësie, pjestim pasurie, vjetërsi pune</i> )	46	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm evidentohet që në pjesën dërrmuese ndihma juridike kërkohet për çështje civile. 2. Krahasimisht evidentohet një rritje e lehtë e çështjeve penale.
Penale	10	
Administrative	5	
<b><u>TOTALI = 61 Vendime Gjyqësore</u></b>		

**6. Të dhëna statistikore: Sipas gjykatave që ka dhënë vendimin.**

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Janar 2022, rezulton se nga **61 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, **të gjitha i përkasin** Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe **asnjë vendim** nuk është dhënë nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë. Këto vendime sipas gjykatave respektive janë të ndara si më poshtë:

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

**Të dhëna statistikore sipas gjykatave që kanë dhënë vendimin  
JANAR 2022**

<i>Gjykata që ka dhënë vendimin me objekt ndihmën juridike</i>	<i>Numri i vendimeve gjyqësore</i>	<i>Komente / të tjera</i>	
<b>Gjykata e Rrethit Gjyqësor</b>	Tiranë	2	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm, numri u vendimeve i përket në pjesën më dërrmuese gjykatave të rrethit krahasimisht me gjykatat administrative. 2. Tërë vendimet gjyqësore për kërkesat mbi ndihmën juridike janë përcjellë nga 12 gjykata të rretheve gjyqësore.
	Durrës	2	
	Elbasan	0	
	Fier	2	
	Gjirokastrë	4	
	Korçë	1	
	Lezhë	10	
	Lushnje	4	
	Berat	0	
	Pogradec	1	
	Vlorë	1	
	Shkodër	12	

	Dibër	0	
	Përmet	0	
	Sarandë	2	
	Kurbin	1	
	Tropojë	0	
<b>Gjykata Administrative e Shkallës së Parë</b>	Tiranë	0	
	Korçë	0	
	Shkodër	0	
<b>Total = 0 Vendime gjyqësore</b>			
<b><u>TOTALI =61 Vendime Gjyqësore</u></b>			

## KONKLUZIONE

### **Sa i përket ndihmës juridike parësore**

- ✓ Nga rastet e administruara për muajin **Janar 2022**, në total rezultojnë **670 raste** nga të cilat **296 raste janë trajtuar nga Qendrat** e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore; **224 raste janë trajtuar nga Organizatat** Jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë; **123 raste janë trajtuar nga Platforma** juristonline.al si dhe **27 raste** janë trajtuar përmes **numrit të gjelbër 08001010**.
- ✓ Sa i përket organizatave jofitimprurëse të autorizuar, organizatat me numrin më të lartë të rasteve të trajtuara vijnë të mbiten: **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, TLAS dhe ALTRI**.
- ✓ Vlen të evidentohet performanca e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në **Tiranë, Durrës dhe Gjirokastrë** ndërsa qendrat që ende kanë nevojë për një promovim të shtuar janë Qendra e **Pogradecit, Dibrës dhe Lushnjës**;
- ✓ **Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë**, pavarësisht rikthimit të studentëve në auditorë dhe zhvillimin e mësimin në kushte normale, **vijnë të mos raportojnë të dhëna**.
- ✓ Fokus shumë i madh po i kushtohet grupeve dhe kategorive vulnerabël dhe në këtë kuadër, nga analiza e të dhënave të muajit Janar 2022, konstatohet se ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore kanë trajtuar një numër të konsiderueshëm të rasteve ku përfitues janë kategoritë në pamundësi financiare;
- ✓ **Vihet re një numër i ulët rastesh kur përfitues kanë qenë të miturit apo personat që i përkasin kategorive romë apo egjiptiane**. Si rrjedhojë, nevojitet një vëmendje e shtuar përmes zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuëse të dedikuara për këto kategori.
- ✓ Së fundmi, sa i përket mënyrës së raportimit të të dhënave konform udhëzimit nr. 1/2019, të Ministrisë të Drejtësisë, **vihet re se disa nga ofruesit vijnë të mos përcjellin të dhënat sipas formatit të kërkuar** (*duke mos specifikuar kategoritë e veçanta përfituese të ligjit*). Lidhur me këtë problematikë, i bëjmë thirrje ofruesve të respektojnë elementët e përcaktuar në udhëzimin nr.1, datë 08.03.2019, *“Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistruara”*).

### **Ndihma Juridike Dytësore**

- ✓ Nga vendimet gjyqësore me objekt ndihmën juridike falas, të administruara nga DNJF për muajin Janar **2022, në total rezultojnë 61 vendime** gjyqësore nga të cilat në **55 vendime janë pranuar** kërkesat për ndihmë juridike dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe në **6 vendim janë rrëzuar, pushuar gjykimi, ose kthyer aktet nga gjykata** lidhur me kërkesat për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore; për mos plotësim dokumentacioni/ mospërbushje të kriterëve të ligjit.
- ✓ **Lidhur me** kategorinë përfituese nga shërbimi i ndihmës juridike, numrin më të madh të të cilëve e përbën gjinia femërore. (*34 përfitues femra dhe 27 përfitues meshkuj*).
- ✓ Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë çështjet civile (*pronësie, pjestim pasurie, heqje zotësie për të vepruar, vjetërsi pune, caktim kujdestarie*)
- ✓ **Lidhur me Gjykatat që kanë dhënë vendimet me objekt ndihmën juridike** dytësore dhe / ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, rezulton se: për muajin Janar 2022, **numrin më të madh të vendimeve e ka dhënë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër**, e pasuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.